



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:058792

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05737238

KPPP.nr. 370/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit Komuna e Pejës – Drejtoria e Inspektoratit, kundër debitorit “Shala Swiss Oil” Sh.P.K., me numër të regjistrimit të biznesit 601239503 dhe me seli në Pejë, rr. “Eliot Engel”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokatura “Krasniqi & Partners” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 05/24, i lejuar më datë 24.01.2024, nga Përmbartuesi Privat Jeton Krasniqi, me seli në Pejë, jashtë seancës me datë 27.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Shala Swiss Oil” Sh.P.K., me numër të regjistrimit të biznesit 601239503 dhe me seli në Pejë, ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 05/24, i lejuar më datë 24.01.2024, nga Përmbartuesi Privat Jeton Krasniqi, ANULOHET.
- II. DETYROHET kreditori, që në emër të shpenzimeve për përpilimin e prapësimit, t’ia paguaj debitorit shumën e përgjithshme në lartësi prej EUR 234.00 (dyqind e tridhjetë e katër Euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komuna e Pejës, mbi bazën e dokumentit përmbartimor, Aktvendimit nr. X-355, të datës 07.11.2023, ka lejuar urdhrin përmbartimor P.nr. 05/24, të datës 24.01.2024, me të cilin është urdhëruar debitori “Shala Swiss Oil” Sh.P.K., që menjëherë pas pranimi të urdhrin, t’ia paguaj kreditorit shumën në lartësi prej EUR 500.00, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor me arsyetim se dokumenti në bazë të së cilit është lejuar përmbartimi nuk është i përshtatshëm për përmbartim, pasi që nuk ka vullë të plotëfuqishmërisë dhe vullë të ekzekutueshmërisë, ashtu që nuk i plotëson kushtet për përmbartim sipas nenit 71, par.1.1 të LPP-së. Më tej, ka theksuar se ndaj vendimit objekt përmbartimi është iniciuar konflikti administrativ, duke kërkuar anulimin e vendimit, pasi që i njëjti vendim është i kundërligjshëm. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të shfuqizohet, si dhe obligohet kreditori që të paguajë shpenzimet për përpilimin e prapësimin në vlerë prej EUR 234.00, sipas tarifës së OAK-së.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (në tekstin e mëtejshëm: “LPP”), gjeti se urdhri përmbartimor duhet të anulohet, për shkak të si në vijim:

Në rastin konkret rezulton se propozimi i kreditorit është ushtruar duke u bazuar në Aktvendimin nr. X-355, të datës 07.11.2023, të Komunës së Pejës, Divizioni për Inspektim Komunal, me të cilin debitori është detyruar që kreditori t’ia paguaj borxhin në lartësi prej EUR 500.00.

Gjykata gjeti se dokumenti mbi të cilin është propozuar lejimi i përmbartimit dhe mbi bazën e të cili përmbartuesi ka lejuar urdhrin përmbartimor, nuk përbën bazë juridike për caktimin e përmbartimit pasi që nuk paraqet titull ekzekutiv në kuptim të nenit 21 të LPP-së, sipas së cilës dispozitë përcaktohet se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*. Ndërsa, me nenin 36, paragrafi 1 të LPP-së, është përcaktuar se *“Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe Faqe 3 nga 3 dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmërisë për përmbartueshmëri”*.

Gjykata, duke ju referuar shkresave të lëndës, gjen se Aktvendimi nr. X-355, i datës 07.11.2023, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbartim, e mbi bazën e të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, nuk ka tipare të përmbartueshmërisë përkatësisht nuk i plotëson kushtet për përmbartim të përcaktuara me nenin 24, paragrafi 3 dhe nenin 36 të LPP-së, pasi që i njëjti nuk

është përmban klauzolën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë, dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit duhet të anulohet.

Lidhur me shpenzimet e procedurës përmbartimore gjykata vendosi në kuptim të dispozitave të nenit 463 të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet debitorit në emër të përpilimit të prapësimit, në shumën prej EUR 234.00 (dyqind e tridhjetë e katër euro), ashtu siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifatat e avokatëve.

Nga sa më sipër, në kuptim të nenit 71 paragrafi, 1, pika 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 370/24, datë 27.05.2024

Gjyqtari  
Arbër Rexha

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.